Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - Ministarstva Obrazovanja Nauke i Tehnologije*
*Ministry of Education Science & Technology*

INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS

# KORNIZA PËR SIGURIM TË CILËSISË SË PERFORMANCËS SË SHKOLLËS NË KOSOVË

Arsim cilësor

Prishtinë, nëntor 2016

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
***Qeveria –Vlada – Government***

*Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë*

INSTITUTI
PEDAGOGJIK
I KOSOVËS

# Korniza për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës në Kosovë

Prishtinë, nëntor 2016

MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
DHE
INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS

**Këshilli redaktues:**

Kabineti i Ministrit, MAShT

Instituti Pedagogjik i Kosovës

Inspektoriati i Arsimit

**Redaktori gjuhësor:**

Bedri Zyberaj

**Radhitja**

Gëzim Duzha

**Ballina**

Gëzim Duzha

**Shtypshkronja:**

**"BLENDI"**

Ky publikim është zhvilluar me mbështetjen e UNICEF-it Zyra në Kosovë
www.unicef.org/kosovo

## PËRMBAJTJA

Fjala e Ministrit ........ 5
Shkurtesat ........ 6
1. Hyrje ........ 7
1.1. Roli i ri i shkollës ........ 7
1.2. Funksioni i këtij dokumenti ........ 8
1.3. Qasja ndaj vlerësimit të performancës së shkollës ........ 8
2. Korniza për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës ........ 9
2.1. Përshkrimi i fushave të cilësisë së performancës së shkollës ........ 9
2.2. Roli dhe rëndësia e parimeve të Kornizës Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar për sistemin e sigurimit të cilësisë së performancës së shkollës ........ 12
2.3. Kriteret e cilësisë së performancës së shkollës në Kosovë ........ 13
3. Nivelet e vlerësimit të performancës së shkollës ........ 30
4. Trendi i performancës së shkollës ........ 31
5. Shkallët e cilësisë së performancës së shkollës ........ 32
Shtojca 1: Formulari për vlerësimin e performancës së shkollës ........ 34
Fjalorthi ........ 67
Biblografia ........ 70
Kontribuesit që morën pjesë në hartimin e Kornizës për sigurim të cilësisë së performances së shkollës ........ 71

## Fjala e Ministrit

Të nderuar mësimdhënës, drejtorë, zyrtarë të DKA-ve dhe udhëheqës të arsimit,

Pesë vjet më parë, kur MASHT-i nxori para jush Kornizën e Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar në Kosovë, ne ishim të vetëdijshëm se, zbatimi efektiv i pakos së re kurrikulare në arsimin parauniversitar, është i mundur vetëm nëse angazhohen të gjitha hallkat e sistemit në mënyrë sistematike drejt përmirësimit dhe avancimit të vazhdueshëm të arritjeve të nxënësve në zotërimin e kompetencave kryesore dhe realizimin e potencialit të tyre.

Pas pilotimit në 95 shkolla, Korniza Kurrikulare u rishikua në vitin 2016. Në këtë rast u identifikuan nevojat për mbështetje të vazhdueshme të shkollave dhe monitorim të procesit. Për të ndihmuar shkollat dhe autoritetet arsimore në kultivimin e kësaj kulture të monitorimit, vlerësimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të shërbimeve dhe politikave arsimore, MAShT-i, tani, sjell para jush *Kornizën për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës në Kosovë.*

Me *Kornizën për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës*, MAShT-i përcakton pritshmërinë themelore nga çdo shkollë që vepron në Republikën e Kosovës, përmes kritereve të cilësisë dhe treguesve të performancës së shkollës. Këto standarde do të shërbejnë si referencë për vlerësimin e performancës së shkollës, planifikimin zhvillimor të saj dhe avancimin e vazhdueshëm të shërbimeve shkollore.

Ky modeli i vlerësimit të performancës së shkollës reflekton qasjen e bazuar në kompetencat për të cilën është përcaktuar komuniteti arsimor në Kosovë që në vitin 2011. Kjo nënkupton që vlerësimi i performancës së shkollës do të jetë i orientuar kah rezultatet e pritura dhe avancimi i nivelit të arritshmërisë së nxënësve. Ky model karakterizohet edhe nga karakteri zhvillimor i vlerësimit të performancës së shkollës, duke e bërë atë më tepër përkrahës të proceseve zhvillimore të shkollës e më pak ndëshkues. Prandaj, është shumë e rëndësishme që të gjithë pjesëmarrësit në vlerësim dhe vetëvlerësim të performancës së shkollës të jenë të sinqertë në identifikimin e problemeve dhe proaktiv në gjetjen e zgjidhjeve dhe aplikimin e masave të planifikuara për përmirësim. Kjo është mënyra e vetme që vlerësimi i performancës së shkollës t'i kontribuojë përmirësimit të cilësisë së shërbimeve shkollore.

Jam krenar që me këtë dokument po bëjmë edhe një hap para drejt vizionit tonë për *arsim cilësor për të gjithë,* dhe, konfirmoj zotimin e MAShT-it që ta monitorojë dhe përkrahë sistemin e vlerësimit të performancës së shkollës deri në funksionalizimin e plotë të tij.

Ky dokument është rezultat i një procesi të gjatë të konsultimit me partnerët tanë dhe me të gjitha palët e interesit. Dëshiroj t'i falënderoj të gjithë për kontributin e dhënë dhe t'ju uroj nismë të mbarë në këtë proces!

**Arsim Bajrami, Ministër**

## Shkurtesat

| | |
|---|---|
| **KK** | Korniza Kurrikulare |
| **KB** | Kurrikula Bërthamë |
| **KSNA** | Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Arsimit (UNESKO) |
| **MASHT** | Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë |
| **PZhSh** | Plani zhvillimor i shkollës |
| **PZhPM** | Plani i zhvillimit profesional të mësimdhënësve |
| **ShK** | Shkallët e kurrikulës |
| **ShPSh** | Shkollat për promovimin e shëndetit |
| **UNESCO** | Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë |
| **UNICEF** | Fondi për Fëmijë i Kombeve të Bashkuara |
| **ZHPM** | Zhvillimi profesional i mësimdhënësve |

# 1. Hyrje

Në kuadër të masave për zbatimin e kornizës së re kurrikulare, në vend, paraqitet e domosdoshme vendosja e një mekanizmi të përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies në institucionet arsimore. Pjesë thelbësore e këtij mekanizmi është përcaktimi i kritereve të cilësisë së shkollës, respektivisht pritshmërisë themelore nga çdo shkollë që vepron në Republikën e Kosovës.

Për këtë arsye, MAShT-i përmes Kornizës për sigurim të cilësisë së përformancës së shkollës synon:

- Mobilizimin e faktorëve brenda dhe jashtë shkollës që mundësojnë përmirësimin dhe avancimin e performancës së saj, përmes vendosjes së një kornize të qartë të pritshmërisë nga shkolla;
- Vendosjen e një standardi të ri në sistemin arsimor, siç është vetëvlerësimi i performancës së shkollës dhe planifikimi zhvillimor përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse.

Këto dy aspekte janë vendimtare në procesin e menaxhimit të institucioneve arsimore duke krijuar bashkëveprim në mes të faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm, në funksion të përmirësimit të shërbimeve arsimore për nxënësit. Njëkohësisht, një qasje e tillë rrit përgjegjësinë dhe ndikon në pedagogjizimin e rrethit në të cilin funksionon shkolla si institucion me vlerë shoqërore. Në gjithë këtë proces përfituesi më i madh do të jetë nxënësi - arsyeja e parë dhe e fundit për ekzistimin e shkollës.

## 1.1. Roli i ri i shkollës

Roli i ri dhe detyra thelbësore e çdo shkolle në Republikën e Kosovës është *të sigurojë zotërimin e kompetencave kryesore të përcaktuara me kurrikulën shtetërore nga të gjithë nxënësit, në një mjedis të sigurt, përfshirës, miqësor dhe inkurajues për gjithë komunitetin shkollor*.

Një shkollë cilësore *shfrytëzon kapacitetin që ka në dispozicion për të ndërtuar profilin e vet në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësve të saj dhe në të mirë të avancimit të lokalitetit në të cilin vepron*.

Për një performancë efektive dhe cilësore çdo shkollë duhet të ketë:

- një vizion të qartë, të ndërtuar përmes një procesi gjithëpërfshirës, të njohur dhe të pranuar nga gjithë komuniteti i shkollës, i cili reflekton nevojat specifike të nxënësve të saj dhe lokalitetit ku vepron;
- mekanizëm efektiv të vetëvlerësimit në raport me treguesit e performancës së shkollës të përcaktuar nga MAShT-i dhe në raport me vizionin e saj;
- procedura të qarta të planifikimit zhvillimor me pjesëmarrje të gjerë;
- agjendë të qartë dhe përkushtim për përmirësim të vazhdueshëm të praktikave të saja, në të mirë të përkrahjes së nxënësve për zotërimin e kompetencave kryesore dhe realizimin e potencialit të vet.

Për ta përmbushur këtë funksion institucioni arsimor duhet ta ketë të qartë pritshmërinë themelore, të definuar përmes kritereve të cilësisë dhe treguesve të performancës së shkollës, e cila do t'i shërbejë si referencë për procesin e vetëvlerësimit por edhe për planifikim zhvillimor dhe avancim të vazhdueshëm të shërbimeve shkollore.

## 1.2. Funksioni i këtij dokumenti

Korniza për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës përcakton:

- Fushat e cilësisë së performancës së shkollës
- Kriteret e cilësisë së performancës së shkollës,
- Treguesit e cilësisë së performancës së shkollës,
- Nivelet e vlerësimit të performancës së shkollës dhe
- Shkallët e cilësisë së performancës së shkollës.

Si i tillë, ky dokument shërben si bazë për sistemin e sigurimit të cilësisë në arsimin parauniversitar, respektivisht si referencë kryesore për vlerësimin dhe vetëvlerësimin e performancës së shkollës, planifikimin zhvillimor të saj dhe avancimin e vazhdueshëm të cilësisë së shkollës.

Duke standardizuar konceptet dhe dispozitat themelore - fushat e cilësisë, kriteret e cilësisë, treguesit e performancës, nivelet e vlerësimit dhe shkallët e cilësisë, Korniza për sigurim të cilësisë siguron koherencë dhe komplementaritet ndërmjet vlerësimit të brendshëm dhe atij të jashtëm të performancës së shkollës dhe ndërmjet niveleve të ndryshme të planifikimit zhvillimor të shkollës.[1]

## 1.3. Qasja ndaj vlerësimit të performancës së shkollës

Qasja e bazuar në kompetencat për të cilën është përcaktuar komuniteti arsimor në Kosovë nënkupton që edhe *vlerësimi i performancës së* shkollës *do të jetë i orientuar kah rezultatet e pritura të performancës*. Mbi këtë bazë, vlerësimi i cilësisë së performancës së shkollës nuk do të përqendrohet në masat e aplikuara apo investimet e shkollës por në efektivitetin e këtyre masave drejt përmbushjes së funksionit të shkollës, respektivisht avansimit të nivelit të arritshmërisë së nxënësve.

Një veçori tjetër e vlerësimit të performancës së shkollës në Kosovë është *karakteri zhvillimor i tij*, duke shërbyer për planifikimin zhvillimor të shkollës dhe për monitorimin e zbatimit të tij nga vet shkolla. Prandaj, vetëvlerësimi në shkollë dhe planifikimi zhvillimor në shkollë janë dy anë të të njëjtit proces dhe përbëjnë një cikël të vlerësimit dhe intervenimit të planifikuar e sistematik që për qëllim përfundimtar kanë përmirësimin e cilësisë së shërbimeve shkollore, bashkëpunimin e komunikimin më të mirë me komunitetin dhe përfundimisht rritjen e kompetencave të nxënësve.

[1] Planifikimit në nivel shkolle, në nivel komune dhe në nivel qendror.

Njëkohësisht, vlerësimi i performancës së shkollës do të shërbejë edhe për përcjelljen, monitorimin dhe mbikëqyrjen e cilësisë së shërbimeve arsimore nga ana e autoriteteve arsimore. Në këtë kontekst, vlerësimi i jashtëm i performancës së shkollës do t'i shërbejë shkollës si bazë për të rishikuar, përmirësuar dhe plotësuar gjetjet nga vlerësimi i brendshëm dhe si bazë për planifikimin zhvillimor të shkollës. Por, raporti i përgjithshëm i vlerësimit të jashtëm të performancës së sistemit arsimor dhe raportet e veçanta për secilën shkollë janë, po ashtu, referencë e rëndësishme për:

a. mbikëqyrjen e cilësisë së shërbimeve të institucioneve arsimore në veçanti dhe
b. të sistemit të arsimit në përgjithësi.

Analiza e mëtejme e situatës së evidentuar në shkolla do të mundësojë identifikimin e sfidave, arritjeve, tendencave dhe një planifikim të informuar të prioriteteve për ngritjen e cilësisë së arsimit në vend dhe/apo në komunë.

## 2. Korniza për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës

Korniza për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës është ndërtuar mbi ndërveprimin në mes të (i) parimeve kryesore të Kornizës Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar të Kosovës (KKAP) dhe (ii) fushave të cilësisë së performancës së shkollës.

Parimet e KKAP përbëjnë fundamentin e sistemit të vlerave të Kornizës për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës, ndërsa fushat e cilësisë i japin strukturën e ndërlidhjen vertikale për vlerësimin e gjendjes dhe për planifikimin e përmirësimit. Pikërisht në ndërveprimin mes të parimeve të KKAP dhe fushave të cilësisë janë përcaktuar kriteret e cilësisë së performancës së shkollës.

Një qasje e tillë komunikon me reformën aktuale kurrikulare, me sistemin e menaxhimit dhe të sigurimit të cilësisë dhe kështu i kontribuon qëndrueshmërisë, ndërlidhjes dhe koherencës në sistemin arsimor të Kosovës.

### 2.1. Përshkrimi i fushave të cilësisë së performancës së shkollës

Korniza parasheh pesë fusha të cilësisë së performancës së shkollës, të cilat shërbejnë si shtylla organizative për menaxhim të shkollës, vlerësim, vetëvlerësim, planifikim dhe intervenim përmirësues. Këto pesë fusha të cilësisë janë:

1) Menaxhimi dhe qeverisja,
2) Kultura dhe mjedisi shkollor,
3) Mësimdhënia dhe nxënia,
4) Zhvillimi profesional i mësimdhënësve, dhe
5) Performanca e nxënësve.

Në vijim përshkruhen shkurtazi fushat e cilësisë së performancës së shkollës.

### 1) Menaxhimi dhe qeverisja:

Procesi i decentralizimit të përgjegjësive arsimore , Korniza Kurrikulare dhe Kurrikulat Bërthamë e kanë zgjeruar autonominë shkollore dhe e kanë shtuar përgjegjësinë dhe shkallën e llogaridhënies për performancën e shkollës e të nxënësve. Kjo ka sjell edhe ndryshimin e rolit, misionit dhe përgjegjësive të udhëheqjes së shkollave. Kuadri udhëheqës i shkollës nuk shihet më si zbatues i urdhrave nga lartë-poshtë, por si strukturë vendimmarrëse që duhet të përqendrohet në proceset e udhëheqjes, menaxhimit, mësimdhënies e nxënies, si dhe në rezultatet mësimore të shkollës. Rrjedhimisht, menaxhmenti i shkollës kosovare është në një proces të tranzicionit nga udhëheqja administrative në „udhëheqje mësimore". Koncepti i *„udhëheqjes mësimore"*, i bënë të veçanta organizatat, të cilat fushëveprim kryesor kanë mësimin dhe të nxënit dhe si të tilla janë përgjegjëse për performancën arsimore të shkollës, për zhvillimin e kompetencave të nxënësve dhe për avancimin e arritshmërisë së nxënësve. Roli dhe përgjegjësitë e reja e kombinojnë udhëheqjen administrative me udhëheqjen mësimore.

Procesi i vlerësimit të performancës së shkollës, në këtë fushë të cilësisë, do të hetojë shkallën dhe natyrën e përfaqësimit të interesave të të gjithë nxënësve dhe nivelin e përfshirjes së komunitetit shkollor në udhëheqjen e shkollës; kapacitetin e shkollës për zhvillim në funksion të përkrahjes së nxënësit drejt zotërimit të kompetencave kryesore; efektivitetin e organeve profesionale të shkollës; cilësinë e planifikimit, realizimit dhe monitorimit të planeve zhvillimore të shkollës; udhëheqjen e zhvillimit të shkollës në përputhje me qëllimin e përcaktuar bashkërisht në shkollë si dhe mënyrën e identifikimit dhe trajtimit të problemeve, sfidave e vështirësive akademike, individuale e grupore në shkollë.

### 2) Kultura dhe mjedisi:

Një mjedis favorizues - atraktiv, miqësor dhe i shëndetshëm- është parakusht themelor për nxënie efektive dhe të qëndrueshme të nxënësve. Autoritetet arsimore, komuniteti, menaxhmenti i shkollës dhe mësimdhënësit duhet t'i plotësojnë të gjitha kushtet përkatëse nëse synohet realizimi i misionit kryesor të shkollës në Kosovë që është *zhvillimi tërësor i kompetencave të nxënësve të përcaktuara me Kornizën Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar (KKAP).*

Në kuadër të kësaj fushe të cilësisë do të vlerësohen: infrastruktura fizike, siguria në shkollë e rreth saj, shkalla e bashkëpunimit të shkollës me familje dhe anasjelltas, mjedisi dhe atmosfera në klasë dhe në shkollë, marrëdhëniet ndërnjerëzore, procedurat dhe masat për të identifikuar dhe adresuar faktorët që mund të pengojnë qasjen, vijueshmërinë dhe arritjet e nxënësve në shkollë si dhe shkallën e pjesëmarrjes së të gjithë faktorëve në përmirësimin e mjedisit dhe kulturës së shkollës.

Një aspekt tjetër, i rëndësishëm, i kësaj fushe është edhe sigurimi i mundësive për një liri krijuese dhe mobilizim të relaksuar të nxënësve, por edhe të mësimdhënësve.

### 3) Mësimdhënia dhe nxënia

Kjo fushë e cilësisë trajton aspektin e mësimdhënies dhe të nxënies si procese arsimore të pandara dhe si dy anë të së njëjtës medalje. Rrjedhimisht, mësimdhënien e mësimdhënësin i sheh në rolin e lehtësuesit dhe në shërbim të nxënies. Njëkohësisht, nxënia shihet dhe kërkohet në tërësinë e saj dhe si e kudondodhshme: në klasë, në shtëpi, në komunitet, në natyrë, në hapësirën kibernetike, në bibliotekë, projekte të ndryshme, e të tjera.

Për matjen e performancës së shkollës, në këtë fushë të cilësisë, do të merren parasysh format e punës në klasë; përvojat e të nxënit; pastaj shkalla e atraktivitetit të mësimdhënies dhe përvojave të nxënies; cilësia e planifikimit, ndërveprimi (në relacionin nxënës – mësimdhënës, nxënës – nxënës); shkalla e zbatimit të formave të përkrahjes së individualizuar në të nxënë dhe vlerësimit në funksion të nxënies; cilësia dhe llojllojshmëria e materialeve mësimore; shkalla e përdorimit të teknologjive të reja; autonomia e nxënësve dhe pjesëmarrja e tyre aktive në proceset e nxënies si dhe relevanca e përmbajtjeve dhe proceseve mësimore në funksion të përgatitjes së nxënësve për mësim gjatë gjithë jetës. Po ashtu, vlerësimi në këtë fushë të cilësisë do t'i kushtojë rëndësi të veçantë edhe përvojave të të nxënit që ndodhin në mes të nxënësve, nxënësve dhe mësimdhënësve dhe nxënësve e komunitetit.

### 4) Zhvillimi profesional i mësimdhënësve:

Institucionet shkollore duhet të mbajnë hapin me arritjet më të reja në fushën e dijes, të shkencës e të teknologjisë për t'i shfrytëzuar ato në avancimin e përvojave të nxënies (si në kuptimin e përmbajtjes, ashtu dhe në metodologjinë e mësimdhënies). Shkolla njëkohësisht duhet të sigurojë që mësimdhënësit të përcjellin trendët e shkencës së pedagogjisë, psikologjisë, shkencave sociale e të tjera por edhe të reflektojnë vazhdimisht për efektivitetin e performancës së tyre në raport me arritjen e pritshmërisë së përcaktuar me kurrikulat bërthamë dhe në raport me performancën e nxënësve.

Vlerësimi i performancës në këtë fushë të cilësisë do të përqendrohet në hetimin dhe vlerësimin e formave të zhvillimit profesional të mësimdhënësve me qëllim të identifikimit dhe përcaktimit të shkallës së qëndrueshmërisë; relevancës dhe ndikimit të tyre në (i) zhvillimin e kompetencave të nxënësve dhe në (ii) përmirësimin e performancës së shkollës. Dy aspekte të tjera me rëndësi për vlerësimin e aktiviteteve të ZHPM, në shkollë, janë shkalla e përkrahjes së mësimdhënësve nga ana e menaxhmentit dhe shkalla e zhvillimit profesional në bazë të nevojave personale dhe planeve individuale zhvillimore të mësimdhënësve. Të gjitha këto, në suaza të një qasjeje koherente e të harmonizuar me misionin dhe objektivat zhvillimore të shkollës.

### 5) Performanca e nxënësve:

Shkolla ekziston për të zhvilluar kompetencat e nxënësve. Kompetencat në KKAP definohen si tërësi e dijeve, shkathtësive dhe vlerave e përgjegjësive të zhvilluara te nxënësit gjatë kohës së shkollimit. Kurrikulat Bërthamë përcaktojnë qartë nivelin e kompetencave që duhen zhvilluar te nxënësit sipas fushave kurrikulare dhe shkallëve kryesore kurrikulare. Perfomanca e nxënësve është fusha thelbësore për vlerësimin e

performancës së shkollës, pasi që pasqyron efektivitetin e shkollës në realizimin e misionit thelbësor të saj.

Vlerësimi i performancës në kuadër të kësaj fushe do të përqendrohet në nivelin e pjesëmarrjes së nxënësve në proceset e shkollës si formë e manifestimit të kompetencës për të ushtruar të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre në kuadër të shkollës; në nivelin dhe cilësinë e pjesëmarrjes në aktivitetet ekstra-kurrikulare në shkollë dhe jashtë saj; në nivelin e zotërimit të kompetencave kryesore; në nivelin e arritshmërisë së rezultateve sipas fushave kurrikulare, arritshmëritë nga kurrikula me zgjedhje dhe angazhimin e tyre për menaxhimin e përparimit vetjak. Performanca e nxënësve manifestohet përmes veprimtarive që nxënësit i ndërmarrin në shkollë; rezultateve të nxënësve në vlerësimet e brendshme dhe të jashtme; projekteve të realizuara nga nxënësit; përfaqësimit dhe suksesit të nxënësve në gara të ndryshme të dijes e shkathtësive në nivel të shkollës, në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar si dhe përfshirjes me sukses të nxënësve në nivele të tjera të shkollimit.

## 2.2. Roli dhe rëndësia e parimeve të Kornizës Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar për sistemin e sigurimit të cilësisë së performancës së shkollës

Me Kornizën Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar (KKAP), të aprovuar nga MAShT-i, është përcaktuar për një qasje të bazuar në kompetenca, respektivisht qasje të orientuar kah rezultatet e pritura që duhet të arrihen nga të gjithë nxënësit në periudha të ndryshme të shkollimit. Për të siguruar koherencën dhe konsistencën e procesit të zbatimit të kësaj qasje, KKAP ka vendos pesë parime themelore që do të merren parasysh:

1) *Gjithëpërfshirja,* e cila i referohet të drejtës së secilit fëmijë dhe të ri për përfshirje të barabartë në arsim cilësor. E udhëhequr nga ky parim, shkolla mundëson qasje dhe përfshirje të barabartë, duke kontribuuar në realizimin e plotë të potencialit individual të secilit fëmijë/të ri në komunitetin në të cilin vepron.
2) *Zhvillimi i kompetencave,* që nënkupton përcaktimin e qartë të dijeve, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave, të cilat shoqëria i konsideron të domosdoshme për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Ky parim duhet të udhëheq gjithë procesin e planifikimit, realizimit dhe vlerësimit të punës së shkollave.
3) *Mësimdhënia dhe të nxënit e integruar*, për të siguruar të nxënit e plotë që reflekton ndërlidhjet dhe ndërvarësitë e natyrës dhe të botës së krijuar nga njeriu me dijen dhe informacionin që kemi për to.
4) *Autonomia dhe fleksibiliteti në nivel shkolle*, që i mundëson shkollës të ndërtojë profilin e vet në interesin më të mirë të nxënësve të saj dhe të lokalitetit në të cilin vepron, në përputhje me kushtet specifike të kuadrit mësimor dhe infrastrukturës së saj dhe brenda kuadrit ligjor të vendosur nga MAShT-i;
5) *Përgjegjësia dhe llogaridhënia*, që nënkupton vendosjen e një mekanizmi të qartë të llogaridhënies për tërë hierarkinë e sistemit të arsimit dhe krijimin e një kulture të vlerësimit dhe zhvillimit të vazhdueshëm të shkollës drejt ngritjes së nivelit të arritjeve të nxënësve.

Këto parime të KKAP-së janë përdorur si fundament i Kornizës për sigurimin e cilësisë së performancës së shkollës, gjithnjë në ndërveprim me pesë fushat e cilësisë së performancës së shkollës.

## 2.3. Kriteret e cilësisë së performancës së shkollës në Kosovë

Korniza e sigurimit të cilësisë përcakton kriteret e cilësisë së performancës së shkollës, të cilat janë referenca kryesore për vlerësimin dhe avancimin e performancës së shkollës në Kosovë. Siç shihet në tabelën vijuese, kriteret reflektojnë ndërveprimin në mes të parimeve të KKAP-së dhe fushave të cilësisë - shtyllave të intervenimit për menaxhimin e shkollës. Kriteret e cilësisë përshkruajnë pritshmërinë themelore që duhet të përmbushet nga çdo shkollë që funksionon në Republikën e Kosovës, orientojnë shkollat për avancim të vazhdueshëm të praktikave të tyre ndërsa autoritetet arsimore për avancim të politikave arsimore.

Kriteret e cilësisë për secilën fushë të cilësisë burojnë nga parimet e KKAP-së. Në këtë mënyrë sigurohet një koherencë dhe konsistencë e procesit të zbatimit të KKAP-së, duke mundësuar edhe një organizim kompakt të fushave të cilësisë (shih Tabelën në vijim). Në këtë kontekst, secila fushë e cilësisë së performancës së shkollës vlerësohet nga perspektiva e pesë parimeve themelore të KKAP-së, prej nga përcaktohen edhe nga pesë kritere të cilësisë për secilën fushë të cilësisë.

## Korniza e kritereve të cilësisë së performancës së shkollës

| PARIMET E KKAP | FUSHAT E PERFORMANCËS SË SHKOLLËS | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | 1 MENAXHIMI DHE QEVERISJA | 2 KULTURA DHE MJEDISI | 3 MËSIMDHËNIA DHE NXËNIA | 4 ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSIMDHËNËSVE | 5 PERFORMANCA E NXËNËSVE |
| | KRITERET E CILËSISË | | | | |
| GJITHËPËRFSHIRJA | 1.1 Organet e qeverisjes janë funksionale dhe efektive në përfaqësimin e interesave të komunitetit të shkollës | 2.1 Objekti dhe hapësirat përcjellëse të shkollës janë të qasshme, të sigurta, të shëndetshme dhe miqësore | .1 Shkolla siguron përfshirjen e nxënësve dhe prindërve në aktivitetet mësimore | 4.1 Menaxhmenti i shkollës përfshin nxënësit, prindërit dhe mësimdhënësit në planifikimin e ZhPM | 5.1 Nxënësit ushtrojnë përgjegjësitë e tyre sociale e qytetare në klasë, në shkollë dhe në komunitet |
| ZHVILLIMI I KOMPETENCAVE | 1.2 Shkolla ka në fokus të orientimit strategjik zhvillimin e kompetencave të nxënësve | 2.2 Shkolla siguron për të gjithë nxënësit mundësi të barabarta për zotërimin e kompetencave | .2 Aktivitetet mësimore mundësojnë mbështetje të diferencuar të nxënësve për zotërimin e kompetencave dhe zhvillimin e potencialit | 4.2 Praktikat e zhvillimit profesional të mësimdhënësve janë në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësve | 5.2 AArritshmëria dhe progresi i nxënësve në zotërimin e kompetencave kryesore plotëson pritshmërinë e vendosura me KB |
| MËSIMDHËNIA DHE NXËNIA E INTEGRUAR | 1.3 Organet profesionale të shkollës janë funksionale dhe efektive në jetësimin e mësimit të integruar | 2.3 Mjedisi dhe kultura e punës së shkollës janë në funksion të nxënies së integruar dhe jetësimit të kurrikulës | .3 Përmbajtjet dhe aktivitetet mësimore janë në funksion të qasjes së integruar | 4.3 Praktikat e zhvillimit profesional të mësimdhënësve janë në funksion të mësimdhënies së integruar | 5.3 Arritshmëria dhe progresi i nxënësve në zotërimin e rezultateve të përcaktuara për fushat kurrikulare plotëson pritshmërinë e vendosura me KB |
| AUTONOMIA DHE FLEKSIBILITETI | 1.4 Prioritetet e zhvillimit të shkollës pasqyrojnë vizionin e saj, nevojat e nxënësve dhe rezultatet e vet-vlerësimit | 2.4 Shkolla ka praktika të konsoliduara të përfshirjes së gjithë komunitetit shkollor në përmirësimin dhe mirëmbajtjen e mjedisit fizik | .4 Autonomia për planifikimin e kurrikulës me zgjedhje shfrytëzohet në mënyrë efektive | 4.4 Shkolla përdorë në mënyrë efikase resurset e saj për aktivitetet e ZhPM | 5.4 Nxënësit janë të angazhuar në aktivitete ekstra-kurrikulare |
| PËRGJEGJËSIA DHE LLOGARIDHËNIA | 1.5 Udhëheqja e shkollës udhëheq dhe monitoron zbatimin e PZhSh dhe politikave arsimore | 2.5 Shkolla ofron një mjedis të sigurt dhe mundësues për realizim të të nxënit efektiv | .5 Shkolla është e angazhuar për përmirësimin e praktikave të mësimdhënies dhe të nxënit | 4.5. Shkolla mbikëqyr ndikimin e ZhPM në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies | 5.5 Nxënësit janë të angazhuar në menaxhimin e përparimit vetjak |

## 2.4 Treguesit e performancës së shkollës

Secili kriter i cilësisë është zbërthyer tutje përmes treguesve të performancës. *Treguesit e performancës janë deklarata afirmative të pritshmërisë themelore nga performanca e* institucionit arsimor*, në kuadër të secilit kriter të cilësisë.*

Shkalla e cilësisë së performancës së shkollës (në nivel të kritereve të cilësisë, në nivel të fushave të cilësisë dhe në nivel të përgjithshëm)[2] përcaktohet në bazë vlerësimit të performancës së shkollës në raport me secilin tregues. Prandaj, treguesit janë referenca kryesore për vlerësimin e performancës së shkollës.

[2] Për më tepër rreth procesit të vlerësimit dhe funksionit të treguesve në këtë proces, shih pjesën 3 dhe 4.

## Treguesit e performancës së shkollës

| Fusha e cilësisë: MENAXHIMI DHE QEVERISJA | |
|---|---|
| **Kriteret e vlerësimit** | **Treguesit e performancës së shkollës** |
| **1.1. Organet e qeverisjes janë funksionale dhe efektive në përfaqësimin e interesave të komunitetit të shkollës** | 1.1.1. Vlerësimet e brendshme të shkollës janë realizuar me pjesëmarrje të të gjithë komunitetit shkollor. |
| | 1.1.2 Nxënësit, mësimdhënësit dhe prindërit janë në dijeni për vizionin dhe misionin e shkollës si dhe për prioritetet e PZhSh-së. |
| | 1.1.3 Organet e qeverisjes (Këshilli i drejtues, Këshilli i prindërve, Këshilli i nxënësve) i kanë definuar përgjegjësitë e veta në zbatimin e PZhSh-së. |
| | 1.1.4 Organet e qeverisjes (Këshilli i drejtues, Këshilli i prindërve, Këshilli i nxënësve) janë funksionale dhe përmbushin obligimet e veta në zbatimin e Planit zhvillimor të shkollës. |
| | 1.1.5 Nxënësit kanë mundësi adekuate për të shprehur qëndrimet e veta. |
| | 1.1.6 Nxënësit janë të përfaqësuar nga organet e përfaqësimit të nxënësve në shkollë sepse qëndrimet e tyre merren parasysh në proceset vendimmarrëse të shkollës. |
| | 1.1.7 Prindërit ndjehen të përfshirë dhe të përfaqësuar nga organet e tyre të përfaqësimit (Këshilli drejtues, Këshillat e prindërve në nivel klase, apo komunitetet tjera të prindërve të themeluara në shkollë). |
| | 1.1.8 Prindërit janë të informuar me të gjitha zhvillimet e rëndësishme në shkollë (proceset e vetëvlerësimit të shkollës, përpilimi i PZhSH, etj.). |
| | 1.1.9 Prindërit kanë mundësi adekuate për të shprehur qëndrimet e veta të cilat shqyrtohen në proceset vendimmarrëse të shkollës. |
| | 1.1.10 Personeli mësimor ndihet i përfaqësuar dhe i vlerësuar në proceset vendimmarrëse të shkollës. |
| | 1.1.11 Personeli tjetër shkollor ndihet i përfaqësuar dhe qëndrimet e tyre për çështjet që i preokupojnë merren parasysh. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 1.2 | **Shkolla ka në fokus të orijentimit strategjik zhvillimin e kompetencave të nxënësve** | 1.2.1 | Shkolla ka ndërtuar një sistem efektiv të administrimit të rezultateve të arritshmërisë së nxënësve[3] në zotërimin e kompetencave në fund të shkallëve kurrikulare. |
| | | 1.2.2 | Vlerësimi i arritshmërisë së nxënësve në zotërimin e kompetencave në fund të shkallëve kurrikulare administrohet në mënyrë efektive dhe bazohet në evidenca. |
| | | 1.2.3 | Analiza e rezultateve të arritshmërisë së nxënësve në zotërimin e kompetencave kryesore shfrytëzohet për identifikimin e faktorëve që pengojnë arritshmërinë e nxënësve dhe planifikimin e masave për evitimin e tyre. |
| | | 1.2.4 | Prioritetet e shkollës përfshijnë masat për evitimin e faktorëve që pengojnë nxënësit në zotërimin e kompetencave. |
| 1.3 | **Organet profesionale të shkollës janë funksionale dhe efektive në jetësimin e mësimit të integruar** | 1.3.1 | Organet profesionale funksionojnë si menaxhment i mesëm në shkollë dhe kanë procedura të qarta të veprimit. |
| | | 1.3.2 | Planet dhe programet mësimore në nivel të shkallëve kurrikulare mundësojnë planifikimin dhe realizimin e proceseve të integruara mësimore. |
| | | 1.3.3 | Planet javore të proceseve mësimore mundësojnë integrim kurrikular. |
| | | 1.3.4 | Organet profesionale të shkollës përgatisin raporte të rregullta për përparimin e bërë në zbatimin e planeve dhe programeve mësimore, sfidat dhe masat për tejkalimin e tyre. |
| | | 1.3.5 | Analiza e arritshmërisë së rezultateve të përcaktuara për fushat kurrikulare shfrytëzohet nga organet profesionale për përmirësimin e praktikave të realizimit të aktiviteteve mësimore. |
| | | 1.3.6 | Shkolla ka ndërtuar një sistem efektiv të administrimit të rezultateve të arritshmërisë së nxënësve në zotërimin e rezultateve të përcaktuara për fushat kurrikulare. |

[3] Sistemi i administrimit të rezultateve të arritshmërisë nënkupton një sistem të analizës dhe shfrytëzimit të rezultateve të vlerësimit nga organet përkatëse të shkollës për përmirësim të proceseve mësimore

| | | |
|---|---|---|
| **1.4 Prioritetet e zhvillimit të shkollës pasqyrojnë vizionin e saj, nevojat e nxënësve dhe rezultatet e vet-vlerësimit** | 1.4.1 | Vizioni dhe misioni i shkollës është koherent me pritshmërinë e nxënësve, prindërve dhe mësimdhënësve. |
| | 1.4.2 | Vlerësimi i brendshëm i performancës së shkollës bëhet në bazë vjetore dhe sipas procedurave të përcaktuara nga MAShT. |
| | 1.4.3 | Prioritetet e PZhSh pasqyrojnë vizionin dhe misionin e shkollës. |
| | 1.4.4 | Raporti i vlerësimit të brendshëm të shkollës pasqyron gjendjen reale në shkollë. |
| | 1.4.5 | Prioritetet e PZhSh pasqyrojnë masat e nevojshme për adresimin e sfidave të identifikuara gjatë vetëvlerësimit të shkollës dhe vlerësimit të jashtëm të shkollës. |
| | 1.4.6 | Prioritetet e planeve vjetore të shkollës adresojnë pikat më të ndjeshme të identifikuara gjatë procesit të vetëvlerësimit dhe rezultateve. |
| **1.5 Menaxhmenti i shkollës udhëheq dhe monitoron zbatimin e PZhSh dhe politikave arsimore** | 1.5.1 | Shkolla ka formuar ekipe pune për realizimin e prioriteteve zhvillimore të shkollës dhe jetësimin e politikave arsimore. |
| | 1.5.2 | Procesi i realizimit të PZhSh mbikëqyret dhe përkrahet vazhdimisht nga organet kompetente të shkollës. |
| | 1.5.3 | Shkolla posedon raporte të rregullta mbi realizimin e PZhSh dhe planit vjetor të veprimit. |
| | 1.5.4 | Përgjegjësia dhe llogaridhënia në nivel shkolle është e qartë për të gjitha nivelet e udhëheqjes së shkollës. |

| Fusha e cilësisë: KULTURA DHE MJEDISI SHKOLLOR | | |
|---|---|---|
| **Kriteret e vlerësimit** | **Treguesit e performancës së shkollës** | |
| **2.1 Objekti dhe hapësirat përcjellëse të shkollës janë të qasshme, të sigurta, të shëndetshme dhe miqësore** | 2.1.1 | Objekti i shkollës, përfshirë oborrin dhe hapësirat përcjellëse të saja, të gjithë nxënësve u mundësojnë qasje dhe lëvizje të lirë. |
| | 2.1.2 | Objekti i shkollës, oborri dhe hapësirat përcjellëse janë të sigurta, të këndshme dhe stimuluese për nxënie, aktivitete sociale dhe rekreative. |
| | 2.1.3 | Nxënësit janë të mbrojtur nga lëndimet dhe dhuna/presioni emocional. |
| | 2.1.4 | Mjedisi fizik i shkollës (ndriçimi, ajrosja, temperatura, lagështia e ajrit, uji i pijshëm, oborri) është i favorshëm për zhvillimin e nxënësve. |
| | 2.1.5 | Higjiena në të gjitha hapësirat e shkollës (brenda dhe jashtë objektit) është në nivel të duhur. |
| | 2.1.6 | Në kuadër të shkollës të gjithë nxënësit, prindërit dhe personeli shkollor trajtohen me dinjitet dhe respekt. |
| | 2.1.7 | Mjedisi i shkollës është mbështetës dhe miqësor, ku të gjithë nxënësit dhe prindërit ndihen të mirëpritur, të përkrahur dhe pjesë e institucionit. |
| **2.2 Shkolla siguron për të gjithë nxënësit mundësi të barabarta për zotërimin e kompetencave** | 2.2.1 | Niveli i pritshmërive të shkollës për zotërimin e kompetencave, për arritjet akademike dhe për realizimin individual të secilit nxënës është i lartë. |
| | 2.2.2 | Ekipi për Parandalim dhe Reagim ndaj mosregjistrimit dhe braktisjes (EPMRB) është funksional dhe ka procedura të qarta për identifikimin e barrierave të cilat mund të pengojnë qasjen, vijueshmërinë dhe arritjet e nxënësve në shkollë. |

| | | |
|---|---|---|
| | 2.2.3 | Shkolla ka krijuar rrjete të bashkëpunimit me ofrues të jashtëm të shërbimeve sociale, shëndetësore e ekonomike për eliminimin e barrierave të cilat pengojnë qasjen, vijueshmërinë dhe arritjet e nxënësve në shkollë. |
| | 2.2.4 | Shkolla mundëson realizimin e potencialit të secilit nxënës përmes aktiviteteve të ndryshme jashtëkurrikulare që kanë për qëllim avancimin e prirjeve individuale të nxënësve. |
| | 2.2.5 | Mësimdhënësit përpilojnë dhe zbatojnë PIA-në për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore. |
| | 2.2.6 | Niveli i braktisjes së shkollës nga nxënësit është shumë i ulët. |
| **2.3 Mjedisi dhe kultura e punës së shkollës janë në funksion të nxënies së integruar dhe jetësimit të kurrikulës** | 2.3.1 | Burimet (njerëzore dhe financiare) dhe pajisjet e mjetet mësimore janë të mjaftueshme për të mundësuar realizimin e procesit mësimor sipas kërkesave të përcaktuara me kurrikulat bërthamë. |
| | 2.3.2 | Pajisjet dhe mjetet mësimore janë të sistemuara, të qasshme dhe shfrytëzohen në mënyrë efektive për të përmbushur nevojat e nxënësve. |
| | 2.3.3 | Nxënësit shfrytëzojnë në mënyrë të pavarur dhe të përgjegjshme burimet të cilat i disponon shkolla. |
| | 2.3.4 | Mësimdhënia dhe nxënia pasurohen me shfrytëzimin adekuat të TIK-ut, mjedisit përreth dhe burimeve të tjera jashtë shkolles. |
| | 2.3.5 | Klasat, laboratorët, hapësirat përcjellëse (të brendshme dhe të jashtme) dhe pajisjet janë në funksion të plotë të realizimit të mësimit të integruar dhe aktiviteteve të tjera me karakter ndërkurrikular. |
| | 2.3.6 | Hapësira të veçanta janë siguruar për realizimin e punës në grupe të vogla të nxënësve e të mësimdhënësve në kuadër të mësimit bashkëpunues. |

| | | |
|---|---|---|
| | 2.3.7 | Seancat e vëzhgimit, reflektimit, vetëreflektimit dhe ndihmës së ndërsjellë praktikohen nga mësimdhënësit në shkollë, me qëllim të përmirësimit të mësimdhënies |
| **2.4 Shkolla ka praktika të konsoliduara të përfshirjes së gjithë komunitetit shkollor në përmirësimin dhe mirëmbajtjen e mjedisit fizik** | 2.4.1 | Shkolla ka praktika të konsoliduara të bashkëpunimit me prindër dhe komunitet në funksion të përmirësimit dhe mirëmbajtjes së mjedisit fizik. |
| | 2.4.2 | Prindërit dhe komuniteti janë të përfshirë në përmirësimin dhe mirëmbajtjen e mjedisit të shkollës. |
| | 2.4.3 | Në kuadër të procesit mësimor dhe aktiviteteve ekstra kurrikulare nxënësit inkurajohen dhe përkrahen që të kontribuojnë në përmirësimin e mjedisit shkollor dhe pasurimin e materialeve mësimore. |
| **2.5 Shkolla ofron një mjedis të sigurtë dhe favorizues për realizim të të nxënit efektiv** | 2.5.1 | Shkolla ka mekanizma efektiv për t'u marrë me rastet e dhunës në shkollë dhe rastet e aksidenteve dhe fatkeqësive elementare. |
| | 2.5.2 | Shkolla ka vendosur një mekanizëm efektiv të menaxhimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të mjedisit fizik shkollor. |
| | 2.5.3 | Shkolla ka standarde të sjelljes, kujdesit dhe mirëqenies, të hartuara në bashkëpunim me organet shkollore, me prindër dhe komunitet. |
| | 2.5.4 | Gjithë personeli i shkollës është në dijeni për të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara me standardet e sjelljes, kujdesit dhe mirëqenies. |
| | 2.5.5 | Pakoja e rregulloreve të shkollës është në funksion të parandalimit të abuzimeve, ekseseve dhe shkeljeve të të gjitha llojeve. |

| Fusha e cilësisë: MËSIMDHËNIA DHE NXËNIA | |
|---|---|
| **Kriteret e vlerësimit** | **Treguesit e performancës së shkollës** |
| **3.1 Shkolla siguron përfshirjen e nxënësve dhe prindërve në aktivitetet mësimore** | 3.1.1 Në shkollë është vendosur një sistem funksional për përfshirjen e prindërve dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm në aktivitetet mësimore të shkollës. |
| | 3.1.2 Metodat e mësimdhënies dhe teknikat e vlerësimit mundësojnë pjesëmarrjen aktive të nxënësve në aktivitetet mësimore. |
| | 3.1.3 Nxënësit përfshihen në përpjekjet për avancimin e aktiviteteve mësimore. |
| | 3.1.4 Prindërit janë të informuar për arritshmërinë, zhvillimin dhe progresin e fëmijëve. |
| | 3.1.5 Prindërit janë të përfshirë në procesin e planifikimit dhe të jetësimit të kurrikulës me bazë në shkollë. |
| | 3.1.6 Nxënësit janë të informuar dhe të vetëdijshëm për arsyeshmërinë e çdo aktiviteti mësimor në të cilin marrin pjesë dhe për përgjegjësinë e tyre që kanë për përmirësim. |
| | 3.1.7 Vlerësimi për të nxënë bëhet me metoda adekuate për inkurajimin dhe motivimin e vazhdueshëm të nxënësve në nxënie. |
| | 3.1.8 Vlerësimi i të nxënit (notimi) është transparent, korrekt dhe ndihmues për nxënësit. |
| | 3.1.9 Preokupimet e nxënësve, të prindërve dhe të kuadrit mësimor lidhur me proceset mësimore janë të pasqyruara në planin e shkollës për përmirësimin e procesit mësimore. |

| | | |
|---|---|---|
| **3.2 Aktivitetet mësimore mundësojnë mbështetje të diferencuar të nxënësve për zotërimin e kompetencave dhe zhvillimin e potencialit të tyre** | 3.2.1 | Procesi i mësimdhënies respekton dhe bazohet në diversitetin e nxënësve. |
| | 3.2.2 | Mësimdhënësit ofrojnë për secilin nxënës përkrahje të individualizuar, për përvetësimin e kompetencave kryesore dhe realizimit të potencialit të tyre. |
| | 3.2.3 | Mësimdhënësit bashkëveprojnë në kuadër të organeve profesionale në procesin e planifikimit dhe zbatimit të qasjeve dhe metodave adekuate për zhvillimin e kompetencave kryesore. |
| | 3.2.4 | Metodat dhe strategjitë e mësimdhënies e të nxënies që praktikohen në klasë dhe jashtë saj janë në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësve. |
| | 3.2.5 | Rezultatet e vlerësimit dhe informatat kthyese të nxënësve shfrytëzohen për të planifikuar dhe përshtatur proceset mësimore në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësve. |
| **3.3 Përmbajtjet dhe aktivitetet mësimore janë në funksion të qasjes së integruar** | 3.3.1 | Planet dhe programet mësimore përgatiten në mënyrë sistematike, me kohë dhe janë në funksion të mësimit të integruar. |
| | 3.3.2 | Përmbajtjet dhe aktivitetet mësimore në kuadër të lëndëve që mbulojnë një fushë kurrikulare janë në funksion të arritjes së rezultateve të përcaktuara për atë fushë kurrikulare. |
| | 3.3.3 | Aktivitetet mësimore integrojnë dhe reflektojnë lidhjet dhe ndërvarësitë në jetën reale. Situatat reale dhe mjetet nga jeta e përditshme janë pjesë integrale e aktiviteteve dhe mjeteve mësimore. |

| | | |
|---|---|---|
| | 3.3.4 | Përmbajtjet dhe aktivitetet mësimore reflektojnë preokupimet e nxënësve, të mjedisit në të cilin vepron shkolla dhe të shoqërisë. |
| | 3.3.5 | Përmbajtjet mësimore reflektojnë zhvillimet në sferën shoqërore, ekonomike, kulturore e shkencore. |
| | 3.3.6 | Aktivitetet mësimore mundësojnë zbatimin e dijes dhe shfrytëzimin e shkathtësive në kontekst të zgjidhjes së problemeve të jetës së përditshme. |
| **3.4 Autonomia për planifikimin e kurrikulës me zgjedhje shfrytëzohet në mënyrë efektive** | 3.4.1 | Organet profesionale dhe qeverisëse të shkollës kanë praktika të konsoliduara për planifikimin dhe jetësimin e kurrikulës me zgjedhje. |
| | 3.4.2 | Kurrikula zgjedhore është në funksion të përmbushjes së nevojave të veçanta të nxënësve, që dalin nga rrethanat dhe veçoritë specifike të komunitetit në të cilin vepron shkolla. |
| | 3.4.3 | Shkolla organizon rregullisht rishikimin dhe freskimin e kurrikulës me zgjedhje duke u bazuar në rezultatet e vlerësimit të arritshmërisë së kompetencave në fund të shkallëve kurrikulare. |
| | 3.4.4 | Udhëheqja e shkollës shfrytëzon autonominë që shkolla ka në dispozicion për të përcaktuar detyrat e personelit mësimor duke u bazuar në përparësitë e secilit mësimdhënës |

| | | |
|---|---|---|
| **3.5 Shkolla është e angazhuar vazhdimisht për përmirësimin e praktikave të mësimdhënies dhe të nxënit** | 3.5.1 | Shkolla reflekton rregullisht mbi cilësinë dhe efektivitetin e përvojave të mësimdhënies dhe nxënies në funksion të zbatimit të kërkesave të kurrikulës dhe përmbushjes së misionit të saj. |
| | 3.5.2 | Mësimdhënësit angazhohen aktivisht në përmirësimin e praktikave të mësimdhënies. |
| | 3.5.3 | Shërbimi profesional është i angazhuar në monitorimin dhe përkrahjen e mësimdhënësve dhe organeve profesionale në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të të nxënit. |
| | 3.5.4 | Qasjet metodologjike dhe materialet mësimore rishikohen çdo vit. |
| | 3.5.5 | Vlerësimi i performancës së mësimdhënësve bëhet në mënyrë të rregullt nga drejtori i shkollës. |

| **Fusha e cilësisë: ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSIMDHËNËSVE** | | |
|---|---|---|
| **Kriteret e vlerësimit** | **Treguesit e performancës së shkollës** | |
| **4.1** | 4.1.2 | PZHPM bazohet në PIZh të mësimdhënësve, prioritetet e shkollës, performancën e mësimdhënësve dhe performancën e nxënësve. |
| | 4.1.3 | Nevojat individuale të mësimdhënësve për zhvillim profesional identifikohen përmes monitorimit të vazhdueshëm të punës së mësimdhënësve. |
| | 4.1.4 | Kapaciteti i mësimdhënësve për të kontribuuar në ZhP të kolegëve të tyre identifikohet përmes monitorimit të vazhdueshëm të punës së mësimdhënësve. |
| | 4.1.5 | Perceptimi i nxënësve dhe prindërve lidhur me performancën e mësimdhënësve shfrytëzohet për vlerësim të nevojave të mësimdhënësve dhe për planifikim të ZhP. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 4.2 | **Praktikat e zhvillimit profesional të mësimdhënësve janë në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësve** | 4.2.1 | Vlerësimi i nevojave të mësimdhënësve për ZhP bazohet në performancën e nxënësve dhe rezultatet e arritshmërisë në zotërimin e kompetencave. |
| | | 4.2.2 | Aktivitetet dhe praktikat e ZHPM adresojnë mangësitë e evidentuara të cilësisë dhe efektivitetit të mësimdhënies për zhvillimin e kompetencave kryesore. |
| | | 4.2.3 | Udhëheqja e shkollës dhe shërbimi profesional monitorojnë ndikimin e ZhPM në ngritjen e cilësisë dhe efektivitetit të mësimdhënies për zhvillimin e kompetencave kryesore. |
| 4.3 | **Praktikat e zhvillimit profesional të mësimdhënësve janë në funksion të mësimdhënies së integruar** | 4.3.1 | Aktivitetet e ZhPM-së pasqyrojnë mangësitë e evidentuara të performancës së mësimdhënësve dhe organeve profesionale të shkollës në planifikimin dhe realizimin e mësimdhënies së integruar. |
| | | 4.3.2 | Udhëheqja e shkollës dhe shërbimi profesional monitorojnë ndikimin e ZhPM në ngritjen e kapacitetit të mësimdhënësve për planifikimin dhe realizimin e mësimdhënies së integruar. |
| 4.4 | **Shkolla përdorë në mënyrë efikase resurset e saj për aktivitetet e ZhPM** | 4.4.1 | Shkolla në kuadër të planit për ZhPM ka planifikuar shfrytëzimin e të gjitha mundësive dhe resurseve që janë në dispozicion brenda shkollës. |
| | | 4.4.2 | Shkolla i inkurajon dhe i përkrah mësimdhënësit në përpjekjet e tyre për ZHPM. |
| | | 4.4.3 | Mësimdhënësit angazhohen në aktivitete ndërvepruese dhe bashkëpunuese në funksion të avancimit të mësimit të integruar në shkollë[4]. |
| | | 4.4.4 | Shkolla ka praktika të bashkëpunimit me shkollat e tjera me qëllim të ZhPM[5]. |

[4] Disa forma të këtyre aktiviteteve janë: Mentorimi kolegial, monitorimi i ndërsjellët, reflektimi kolegial, seancat e diskutimit, aftësimi dhe reflektimi në nivel të organeve profesionale, të nxënit bashkëpunues e të tjera

[5] Si më lart

| | | |
|---|---|---|
| **4.5 Shkolla mbikqyrë ndikimin e ZhPM në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies** | 4.5.1 | Shkolla ka planin e vet për zhvillim profesional të mësimdhënësve (PZhPM). |
| | 4.5.2 | Në PIZh mësimdhënësit reflektojnë lidhur me ndikimin e ZHP në punën e tyre. |
| | 4.5.3 | Shkolla mbikqyrë dhe evidenton ndikimin e ZhPM në planifikimin dhe realizmin e proceseve mësimore. |
| | 4.5.4 | Shkolla përdorë gjetjet e monitorimit të ZHPM për planifikimin e zhvillimit profesional të mësimdhënësve. |
| | 4.5.5 | Shkolla përdorë resurset e veta për aktivitete të ZhPM në mënyrë efektive, të drejtë dhe transparente. |

**Fusha e cilësisë: PERFORMANCA E NXËNËSVE**

| **Kriteret e vlerësimit** | | **Treguesit e performancës së shkollës** |
|---|---|---|
| **5.1 Nxënësit ushtrojnë përgjegjësitë e tyre sociale e qytetare në klasë, në shkollë dhe në komunitet** | 5.1.1 | Nxënësit ndjehen të sigurt, të respektuar, të përmbushur, të përfshirë në aktivitetet shkollore dhe përgjegjës që t'i kontribuojnë klimës pozitive në shkollë. |
| | 5.1.2 | Nxënësit njohin, kuptojnë dhe ushtrojnë të drejtat e veta si dhe respektojnë të drejtat e të tjerëve. |
| | 5.1.3 | Nxënësit kanë vetërespekt dhe tregojnë konsideratë dhe respekt për njëri-tjetrin dhe për të tjerët. |
| | 5.1.4 | Nxënësit janë në gjendje të veprojnë në mënyrë të pavarur dhe të përgjegjshme. |
| | 5.1.5 | Nxënësit janë aktiv dhe vigjilent për identifikimin e problemeve në klasë, në shkollë dhe në komunitet. |

| | | |
|---|---|---|
| | 5.1.6 | Nxënësit manifestojnë iniciativë dhe aftësi për planifikim, organizim, bashkëpunim e angazhim të përgjegjshëm për adresimin e problemeve të identifikuara në klasë, në shkollë dhe në komunitet. |
| | 5.1.7 | Nxënësit mbështeten nga shkolla për adresimin e nevojave dhe kërkesave të tyre në lidhje me organizimin, planifikimin dhe përmirësimin e jetës së tyre në shkollë. |
| | 5.1.8 | Iniciativat e nxënësve janë të evidentuara dhe të vlerësuara. |
| | | |
| **5.2 Arritshmëria dhe progresi i nxënësve në zotërimin e kompetencave kryesore plotëson pritshmëritë e vendosura me KB** | 5.2.1 | Niveli i zotërimit të kompetencës së komunikimit dhe të shprehurit plotëson pritshmëritë e vendosura në KB. |
| | 5.2.2 | Niveli i zotërimit të kompetencës së të menduarit kritik dhe kreativ plotëson pritshmëritë e vendosura në KB. |
| | 5.2.3 | Niveli i zotërimit të kompetencës së të mësuarit plotëson pritshmëritë e vendosura në KB. |
| | 5.2.4 | Niveli i zotërimit të kompetencës që ka të bëjë me jetën, punën dhe mjedisin plotëson pritshmëritë e vendosura në KB. |
| | 5.2.5 | Niveli i zotërimit të kompetencës personale plotëson pritshmëritë e vendosura në KB. |
| | 5.2.6 | Niveli i zotërimit të kompetencës qytetare plotëson pritshmëritë e vendosura në KB. |
| **5.3 Arritshmëria dhe progresi i nxënësve në zotërimin e rezultateve të përcaktuara për fushat kurrikulare i plotëson** | 5.3.1 | Niveli i arritshmërisë së nxënësve në zotërimin e rezultateve të përcaktuara për fushën gjuhës dhe të komunikimin i plotëson pritshmëritë e vendosura në KB. |
| | 5.3.2 | Niveli i arritshmërisë së nxënësve në zotërimin e rezultateve të përcaktuara për fushën e matematikës i plotëson pritshmëritë e vendosura në KB. |
| | 5.3.3 | Niveli i arritshmërisë së nxënësve në zotërimin e rezultateve të përcaktuara për fushën e arteve i plotëson pritshmëritë e vendosura në KB. |

| | | |
|---|---|---|
| pritshmëritë e vendosura me KB | 5.3.4 | Niveli i arritshmërisë së nxënësve në zotërimin e rezultateve të përcaktuara për fushën e shkencave shoqërore i plotëson pritshmëritë e vendosura në KB. |
| | 5.3.5 | Niveli i arritshmërisë së nxënësve në zotërimin e rezultateve të përcaktuara për fushën shkencave natyrore i plotëson pritshmëritë e vendosura në KB. |
| | 5.3.6 | Niveli i arritshmërisë së nxënësve në zotërimin e rezultateve të përcaktuara për fushën jeta dhe puna i plotëson pritshmëritë e vendosura në KB. |
| | 5.3.7 | Niveli i arritshmërisë së nxënësve në zotërimin e rezultateve të përcaktuara për fushën edukata fizike, sportet dhe shëndeti, i plotëson pritshmëritë e vendosura në KB. |
| **5.4 Nxënësit janë të përfshirë në aktivitete ekstra-kurrikulare** | 5.4.1 | Nxënësit janë të përfshirë në përgatitjen e programit për aktivitetet ekstra-kurrikulare në shkollë dhe jashtë saj. |
| | 5.4.2 | Të gjithë nxënësit janë të përfshirë në së paku në një aktivitet ekstra-kurrikular. |
| | 5.4.3 | Nxënësit janë të motivuar për pjesëmarrje në aktivitetet ekstra-kurrikulare. |
| **5.5 Nxënësit janë të angazhuar në menaxhimin e përparimit vetjak** | 5.5.1 | Nxënësit janë të vetëdijshëm për përparësitë dhe mangësitë e veta. Ata i kanë të qarta planet për të përparuar. |
| | 5.5.2 | Nxënësit i kërkojnë dhe i shfrytëzojnë këshillat, burimet e ndryshme të informacionit dhe përkrahjen kur është e nevojshme. |
| | 5.5.3 | Nxënësit në vijimësi janë të angazhuar në menaxhimin e përparimit të tyre. Ata mbajnë portfolio të përparimit dhe reflektojnë për përparimin e tyre. |

## 3. Nivelet e vlerësimit të performancës së shkollës

Vlerësimi i shkollës do të realizohet në tre nivele:

- Në nivel të kritereve të cilësisë
- Në nivel të  fushave të cilësisë dhe
- Në nivel të përgjithshëm

**Vlerësimi në nivel të kritereve** është një përshkrim i gjendjes së evidentuar dhe të trendit të performancës së shkollës në raport me secilin tregues të kriterit përkatës (shih Shtojca 1: Instrumenti i vlerësimit të performancës së shkollës). Me këtë rast përcaktohet dhe shkalla e cilësisë së performancës për kriterin përkatës (shih pjesën 4)

**Vlerësimi i performancës së shkollës në nivel të fushave të cilësisë** do të përqendrohet në:

- Përcaktimin e shkallës së cilësisë së performancës në fushën përkatëse,
- Përmbledhjen e gjendjes reale të shkollës në kuadër të fushës përkatëse, duke u bazuar në gjetjet  e evidentuara në raport me treguesit për secilin kriter të fushës përkatëse,
- Paraqitjen e evidencave/dëshmive që mbështesin gjetjet e konstatuara në raport me treguesit, për secilin kriter të fushës përkatëse, dhe
- Konstatimin e trendit (krahasuar me vlerësimin paraprak), evidentimin e ndikimit negativ apo pozitiv të faktorëve që janë jashtë kontrollit të institucionit arsimor dhe masat që do të ndërmerren nga shkolla për adresimin e këtyre ndikimeve.

**Vlerësimi i performancës së përgjithshme të shkollës** përmban një përmbledhje të gjendjes së konstatuar në nivel të fushave të cilësisë që kanë qenë objekt i vlerësimit dhe vetëvlerësimit të shkollës. Ky vlerësim bëhet nga perspektiva e ndikimit që kanë pasur praktikat shkollore te nxënësit dhe nxënia e tyre, në kuadër të fushave përkatëse të cilësisë.

Me rastin e vlerësimit të përgjithshëm, shkolla identifikon edhe përparësitë dhe dobësitë e performancës së saj dhe masat që duhet të ndërmerren për (i) mirëmbajtjen dhe avansimin e përparësive dhe (ii) për përmirësimin e anëve të dobëta, respektivisht tejkalimin e sfidave të evidentuara.

## 4. Trendi i performancës së shkollës

Aspekti më i rëndësishëm i vlerësimit dhe vetëvlerësimit të performancës së shkollës është ndikimi që kanë pasur praktikat e shkollës te nxënësit dhe nxënia e tyre. Kjo nënkupton që theksi i vlerësimit do të vendoset në efektin që kanë pasur masat e aplikuara nga shkolla për përmirësimin e trendit të performancës së shkollës. Prandaj, vlerësimi i performancës së shkollës, krahas gjetjeve në raport me gjendjen, do të evidentojë edhe trendin e performancës.

Trendi i performancës konstatohet për secilin tregues. Mbi këtë bazë konstatohet edhe trendi i performancës në kuadër të fushave të cilësisë dhe pastaj trendi i përgjithshëm i performancës së shkollës.

Shkalla për përcaktimin e trendit të performancës së institucionit arsimor është si vijon:

| Trendi | Përshkrimi |
|---|---|
| ***Përsosje*** | *Ky trend e karakterizon shkollën e cila është inovative dhe e përkushtuar për avancim të vazhdueshëm të të gjitha aspekteve të veprimtarisë së saj, edhe pse performanca e saj edhe në vlerësimin paraprak ka qenë në nivel të shkëlqyeshëm.* |
| ***Mirëmbajtje*** | *Ky trend e karakterizon shkollën e cila mirëmban një nivel të mirë apo të shkëlqyeshëm të performancës.* |
| ***Përmirësim*** | *Ky trend e karakterizon shkollën e cila ka ngritje të nivelit të performancës nga niveli i pranueshëm në nivel të mirë, apo nga niveli i mirë në atë të shkëlqyeshëm* |
| ***Stagnim*** | *Ky trend e karakterizon shkollën e cila mban një nivel të pranueshëm (të ulët) të performances, pa tendencë përmirësimi* |
| ***Rënie*** | *Ky trend e karakterizon shkollën niveli i së cilës ka pësuar rënie në performancë krahasuar me nivelin e performancës së konstatuar gjatë vlerësimit paraprak* |

## 5. Shkallët e cilësisë së performancës së shkollës

Cilësia e performancës së shkollës në nivel të kritereve të cilësisë, në nivel të fushave të cilësisë dhe në nivel të përgjithshëm, kategorizohet në njërën nga katër shkallët vijuese:

- Performancë e shkëlqyeshme
- Performancë e mirë
- Performancë e pranueshme
- Performancë e papranueshme

Si referencë për përcaktimin e cilësisë së performancës së shkollës në nivel të kritereve të cilësisë, në nivel të fushave të cilësisë dhe në nivel të përgjithshëm shërben tabela në vijim:

| *Cilësia e performancës* | *Përshkrimi* |
|---|---|
| ***Performancë e shkëlqyeshme*** | *Shkolla në kuadër të kriterit/fushës përkatëse të cilësisë (apo në nivel të përgjithshëm[6]) përmbush obligimet ligjore në nivel të avancuar dhe ka qasje inovative dhe efektive në adresimin e nevojave specifike të nxënësve të saj dhe të komunitetit në të cilin vepron. Përvojat e nxënësve në shkollë dhe arritjet e tyre janë të një cilësie shumë të lartë.*<br><br>*Performanca e shkollës karakterizohet me arritshmëri të lartë të pritshmërisë dhe me performancë të shquar në të gjithë treguesit (me rastin e vlerësimit të kriterit), në të gjitha kriteret (me rastin e vlerësimit të fushës përkatëse të cilësisë), respektivisht në të gjitha fushat e performancës (me rastin e vlerësimit të përgjithshëm).*<br><br>*Kjo nënkupton që performanca e shkollës është e qëndrueshme ndërsa përkushtimi dhe kapaciteti i shkollës është në nivelin e duhur për ta mirëmbajtur këtë performancë.* |
| ***Performancë e mirë*** | *Shkolla në kuadër të kriterit përkatës, fushës përkatëse të cilësisë apo në nivel të përgjithshëm përmbush obligimet themelore ligjore në mënyrë korrekte dhe në masë të konsiderueshme adreson nevojat specifike të nxënësve të saj dhe të komunitetit në të cilin vepron.*<br><br>*Performanca e shkollës ka anët e saj të forta dhe ato të dobëta, por, dominojnë anët e forta. Performancën e shkollës e karakterizon një trend pozitiv.*<br><br>*Kjo nënkupton që shkolla ka një performancë të mirë, por nevojitet avancim i mëtejmë i nivelit të performancës në kuadër të kritereve, respektivisht  fushave të caktuara të cilësisë.* |

[6] Varësisht se a konstatohet cilësia e kriterit të cilësisë, fushës së performancës apo cilësia e përgjithshme e shkollës

| | |
|---|---|
| ***Performancë e pranueshme*** | *Shkolla në kuadër të kriterit përkatës, fushës përkatëse të cilësisë apo në nivel të përgjithshëm përmbush të gjitha obligimet themelore, por në nivel modest. Iniciativat për adresimin e nevojave specifike të nxënësve të saj dhe komunitetit ku vepron ende nuk janë konsoliduar dhe nuk kanë dëshmuar impaktin e tyre.*<br><br>*Performanca e shkollës ka anët e saj të forta dhe ato të dobëta, por, dominojnë anët e dobëta dhe nuk është konstatuar tendencë e avancimit.*<br><br>*Kjo nënkupton që shkolla, në kuadër të fushës përkatëse të cilësisë (apo në nivel të përgjithshëm), ka nevojë për masa të strukturuara dhe të planifikuara nën mbikëqyrje dhe përkrahje të shtuar për evitimin e vështirësive dhe përmirësimin e performancës.* |
| ***Performancë e papranueshme*** | *Performanca e shkollës në kuadër të kriterit përkatës, fushës përkatëse të cilësisë, apo në nivel të përgjithshëm është kryesisht në nivel modest, por në njërin prej treguesve, kritereve, respektivisht fushave të cilësisë (apo më tepër) performanca e shkollës është e papranueshme[7]. Pra, në një apo më tepër fusha të cilësisë shkolla nuk përmbush obligimet themelore ligjore dhe ka nevojë për masa të menjëhershme, të strukturuara dhe të planifikuara nën mbikëqyrje dhe përkrahje të shtuar për evitimin e vështirësive.* |

[7] *Në nivel të vlerësimit të kriterit të cilësisë*, performanca e shkollës është e papranueshme nëse në raport me një tregues (apo më tepër) shkolla ka performancë të papranueshme; *në nivel të fushës së cilësisë*, performanca është e papranueshme nëse një kriter (apo më tepër) në kuadër të asaj fushe nuk përmbushet fare; *në nivel të përgjithshëm*, performanca e shkollës është e papranueshme kur në njërën prej fushave të cilësisë performanca e saj është e papranueshme.

## Shtojca 1: Formulari për vlerësimin e performancës së shkollës

**Të dhënat e përgjithshme**

---

**Emri i shkollës:**

**Lokacioni/adresa:**

**Komuna:**

**Periudha e realizimit të vlerësimit:**

**Data e përfundimit të raportit:**

| **Konteksti i përgjithshëm i shkollës** |
|---|
| |

| **Procesi i mbledhjes së të dhënave** |
| --- |
| |

| Fusha e cilësisë 1: MENAXHIMI DHE QEVERISJA | | |
|---|---|---|
| **Kriteri 1.1: Mekanizmat e qeverisjes janë funksional dhe efektiv në përfaqësimin e interesave të komunitetit të shkollës** | | |
| **Treguesit** | | **Trendi** |
| **1.1.1.** | | |
| **1.1.2.** | | |
| **1.1.3.** | | |
| **1.1.4.** | | |
| **1.1.5.** | | |
| **1.1.6.** | | |
| **1.1.7.** | | |
| **1.1.8.** | | |
| **1.1.9.** | | |
| **1.1.1** | | |
| **1.1.1** | | |
| **Shkalla e cilësisë:** | | |

| | | |
|---|---|---|
| **Fusha e cilësisë 1: MENAXHIMI DHE QEVERISJA** | | |
| **Kriteri 1.2: Shkolla ka në fokus të orientimit strategjik zhvillimin e kompetencave të nxënësve** | | |
| **Treguesit** | | **Trendi** |
| **1.2.1** | | |
| **1.2.2** | | |
| **1.2.3** | | |
| **1.2.4** | | |
| **Shkalla e cilësisë:** | | |

| Fusha e cilësisë 1: MENAXHIMI DHE QEVERISJA | | |
|---|---|---|
| **Kriteri 1.3: Organet profesionale të shkollës janë funksionale dhe efektive në jetësimin e mësimit të integruar** | | |
| **Treguesit** | | **Trendi** |
| **1.3.1** | | |
| **1.3.2** | | |
| **1.3.3** | | |
| **1.3.4** | | |
| **1.3.5** | | |
| **1.3.6** | | |
| **Shkalla e cilësisë:** | | |

<table>
<tr><td colspan="3">Fusha e cilësisë 1: MENAXHIMI DHE QEVERISJA</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kriteri 1.4: Prioritetet e zhvillimit të shkollës e pasqyrojnë vizionin e saj, nevojat e nxënësve dhe rezultatet e vetëvlerësimit</td></tr>
<tr><td colspan="2">Treguesit</td><td>Trendi</td></tr>
<tr><td>1.4.1</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td>1.4.2</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td>1.4.3</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td>1.4.4</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td>1.4.5</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td>1.4.6</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td colspan="3">Shkalla e cilësisë:</td></tr>
</table>

| Fusha e cilësisë 1: MENAXHIMI DHE QEVERISJA | | |
|---|---|---|
| **Kriteri 1.5: Udhëheqja e shkollës udhëheq dhe monitoron zbatimin e PZhSh dhe politikave arsimore** | | |
| **Treguesit** | | **Trendi** |
| **1.5.1** | | |
| **1.5.2** | | |
| **1.5.3** | | |
| **1.5.4** | | |
| **Shkalla e cilësisë:** | | |

| **Vlerësimi i fushës së cilësisë** | | |
|---|---|---|
| **Fusha e cilësisë: MENAXHIMI DHE QEVERISJA** | | |
| **Shkalla e cilësisë:** | | |
| **Përshkrim i performancës së shkollës** | **Dëshmitë/evidencat** | **Komentet shtesë** |
| | | |

| | | |
|---|---|---|
| **Fusha e cilësisë 2: KULTURA DHE MJEDISI SHKOLLOR** | | |
| **Kriteri 2.1: Objekti dhe hapësirat tjera të shkollës janë të qasshme, të sigurta, të shëndetshme dhe miqësore** | | |
| | **Treguesit** | **Trendi** |
| **2.1.1** | | |
| **2.1.2** | | |
| **2.1.3** | | |
| **2.1.4** | | |
| **2.1.5** | | |
| **2.1.6** | | |
| **2.1.7** | | |
| **Shkalla e cilësisë:** | | |

| Fusha e cilësisë 2: KULTURA DHE MJEDISI SHKOLLOR | | |
|---|---|---|
| **Kriteri 2.2: Shkolla siguron për të gjithë nxënësit mundësi të barabarta për zotërimin e kompetencave** | | |
| | **Treguesit** | **Trendi** |
| **2.2.1** | | |
| **2.2.2** | | |
| **2.2.3** | | |
| **2.2.4** | | |
| **2.2.5** | | |
| **2.2.6** | | |
| **Shkalla e cilësisë** | | |

| Fusha e cilësisë 2: KULTURA DHE MJEDISI SHKOLLOR | | |
|---|---|---|
| **Kriteri 2.3: Mjedisi dhe kultura e punës së shkollës janë në funksion të nxënies së integruar dhe jetësimit të kurrikulës** | | |
| **Treguesit** | | **Trendi** |
| **2.3.1** | | |
| **2.3.2** | | |
| **2.3.3** | | |
| **2.3.4** | | |
| **2.3.5** | | |
| **2.3.6** | | |
| **2.3.7** | | |
| **Shkalla e cilësisë:** | | |

| **Fusha e cilësisë 2: KULTURA DHE MJEDISI SHKOLLOR** | | |
|---|---|---|
| **Kriteri 2.4: Shkolla ka praktika të konsoliduara të përfshirjes së gjithë komunitetit shkollor në përmirësimin dhe mirëmbajtjen e mjedisit fizik** | | |
| **Treguesit** | | **Trendi** |
| **2.4.1** | | |
| **2.4.2** | | |
| **2.4.3** | | |
| **2.4.4** | | |
| **Shkalla e cilësisë:** | | |

| Fusha e cilësisë 2: KULTURA DHE MJEDISI SHKOLLOR | | |
|---|---|---|
| **Kriteri 2.5: Shkolla ofron një mjedis favorizues (atraktiv, miqësor dhe të shëndetshëm) për realizim të të nxënit efektiv** | | |
| **Treguesit** | | **Trendi** |
| **2.5.1** | | |
| **2.5.2** | | |
| **2.5.3** | | |
| **2.5.4** | | |
| **2.5.5** | | |
| **Shkalla e cilësisë:** | | |

<table>
<tr><td colspan="3" align="center">Vlerësimi i fushës së cilësisë</td></tr>
<tr><td colspan="3">Fusha e cilësisë: KULTURA DHE MJEDISI SHKOLLOR</td></tr>
<tr><td colspan="3">Shkalla e cilësisë:</td></tr>
<tr><td align="center">Përshkrim i performancës së shkollës</td><td align="center">Dëshmitë/evidencat</td><td align="center">Komentet shtesë</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td></td></tr>
</table>

| Fusha e cilësisë 3: MËSIMDHËNIA DHE NXËNIA | | |
|---|---|---|
| **Kriteri 3.1: Shkolla siguron përfshirjen e nxënësve dhe të prindërve në veprimtaritë mësimore** | | |
| **Treguesit** | | **Trendi** |
| **3.1.1** | | |
| **3.1.2** | | |
| **3.1.3** | | |
| **3.1.4** | | |
| **3.1.5** | | |
| **3.1.6** | | |
| **3.1.7** | | |
| **3.1.8** | | |
| **3.1.9** | | |
| **Shkalla e cilësisë:** | | |

| **Fusha e cilësisë 3: MËSIMDHËNIA DHE NXËNIA** | | |
|---|---|---|
| **Kriteri 3.2: Veprimtaritë mësimore mundësojnë mbështetje të diferencuar të nxënësve për zotërimin e kompetencave dhe zhvillimin e potencialit të tyre** | | |
| **Treguesit** | | **Trendi** |
| **3.2.1** | | |
| **3.2.2** | | |
| **3.2.3** | | |
| **3.2.4** | | |
| **3.2.5** | | |
| **Shkalla e cilësisë** | | |

| Fusha e cilësisë 3: MËSIMDHËNIA DHE NXËNIA | | |
|---|---|---|
| **Kriteri 3.3: Përmbajtjet dhe veprimtaritë mësimore janë në funksion të qasjes së integruar** | | |
| **Treguesit** | | **Trendi** |
| **3.3.1** | | |
| **3.3.2** | | |
| **3.3.4** | | |
| **3.3.5** | | |
| **3.3.6** | | |
| **3.3.7** | | |
| **Shkalla e cilësisë:** | | |

| **Fusha e cilësisë 3: MËSIMDHËNIA DHE NXËNIA** | | |
|---|---|---|
| **Kriteri 3.4: Autonomia për planifikimin e kurrikulës me zgjedhje shfrytëzohet në mënyrë efektive** | | |
| **Treguesit** | | **Trendi** |
| **3.4.1** | | |
| **3.4.2** | | |
| **3.4.3** | | |
| **3.4.4** | | |
| **Shkalla e cilësisë:** | | |

| **Fusha e cilësisë 3:** MËSIMDHËNIA DHE NXËNIA | | |
|---|---|---|
| **Kriteri 3.5: Shkolla është e angazhuar vazhdimisht për përmirësimin e praktikave të mësimdhënies dhe të të nxënit** | | |
| **Treguesit** | | **Trendi** |
| **3.5.1** | | |
| **3.5.2** | | |
| **3.5.3** | | |
| **3.5.4** | | |
| **3.5.5** | | |
| **Shkalla e cilësisë:** | | |

| Vlerësimi i fushës së cilësisë | | |
|---|---|---|
| **Fusha e cilësisë: MËSIMDHËNIA DHE NXËNIA** | | |
| **Shkalla e cilësisë:** | | |
| **Përshkrim i performancës së shkollës** | **Dëshmitë/evidencat** | **Komentet shtesë** |
| | | |

<table>
<tr><td colspan="3">Fusha e cilësisë 4: ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSIMDHËNËSVE</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kriteri 4.1: Menaxhmenti i shkollës përfshin nxënësit, prindërit dhe mësimdhënësit në planifikimin e ZhPM</td></tr>
<tr><td colspan="2">Treguesit</td><td>Trendi</td></tr>
<tr><td>4.1.2</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td>4.1.3</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td>4.1.4</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td>4.1.5</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td colspan="3">Shkalla e cilësisë:</td></tr>
</table>

| **Fusha e cilësisë 4: ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSIMDHËNËSVE** | | |
|---|---|---|
| **Kriteri 4.2: Praktikat e zhvillimit profesional të mësimdhënësve janë në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësve** | | |
| **Treguesit** | | **Trendi** |
| **4.2.1** | | |
| **4.2.2** | | |
| **4.2.3** | | |
| **Shkalla e cilësisë:** | | |

| **Fusha e cilësisë 4:** ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSIMDHËNËSVE | | |
|---|---|---|
| **Kriteri 4.3: Praktikat e  zhvillimit profesional të mësimdhënësve janë në funksion të mësimdhënies së integruar** | | |
| | **Treguesit** | **Trendi** |
| **4.3.1** | | |
| **4.3.2** | | |
| **Shkalla e cilësisë:** | | |

| | | |
|---|---|---|
| **Fusha e cilësisë 4: ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSIMDHËNËSVE** | | |
| **Kriteri 4.4: Shkolla përdorë në mënyrë efikase resurset e veta për aktivitetet e ZhPM** | | |
| | **Treguesit** | **Trendi** |
| **4.4.1** | | |
| **4.4.2** | | |
| **4.4.3** | | |
| **4.4.4** | | |
| **Shkalla e cilësisë:** | | |

| **Fusha e cilësisë 4:** ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSIMDHËNËSVE | | |
|---|---|---|
| **Kriteri 4.5: Shkolla mbikëqyrë ndikimin e ZhPM në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies** | | |
| **Treguesit** | | **Trendi** |
| **4.5.1** | | |
| **4.5.2** | | |
| **4.5.3** | | |
| **4.5.4** | | |
| **4.5.5** | | |
| **Shkalla e cilësisë:** | | |

<table>
<tr><td colspan="3" align="center">Vlerësimi i fushës së cilësisë</td></tr>
<tr><td colspan="3">Fusha e cilësisë: ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSIMDHËNËSVE</td></tr>
<tr><td colspan="3">Shkalla e cilësisë:</td></tr>
<tr><td align="center">Përshkrim i performancës së shkollës</td><td align="center">Dëshmitë/evidencat</td><td align="center">Komentet shtesë</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td></td></tr>
</table>

| Fusha e cilësisë 5: PERFORMANCA E NXËNËSVE | | |
|---|---|---|
| **Kriteri 5.1: Nxënësit ushtrojnë përgjegjësitë e veta sociale e qytetare në klasë, në shkollë dhe në komunitet** | | |
| **Treguesit** | | **Trendi** |
| **5.1.1** | | |
| **5.1.2** | | |
| **5.1.3** | | |
| **5.1.4** | | |
| **5.1.5** | | |
| **5.1.6** | | |
| **5.1.7** | | |
| **5.1.8** | | |
| **Shkalla e cilësisë:** | | |

| Fusha e cilësisë 5: PERFORMANCA E NXËNËSVE | | |
|---|---|---|
| **Kriteri 5.1: Arritshmëria dhe progresi i nxënësve në zotërimin e kompetencave kryesore plotëson pritshmërinë e vendosur me KB** | | |
| | **Treguesit** | **Trendi** |
| **5.2.1** | | |
| **5.2.2** | | |
| **5.2.3** | | |
| **5.2.4** | | |
| **5.2.5** | | |
| **5.2.6** | | |
| **Shkalla e cilësisë:** | | |

| Fusha e cilësisë 5: PERFORMANCA E NXËNËSVE | | |
|---|---|---|
| **Kriteri 5.3: Arritshmëria dhe progresi i nxënësve në zotërimin e rezultateve të përcaktuara për fushat kurrikulare plotëson pritshmërinë e vendosur me KB** | | |
| **Treguesit** | | **Trendi** |
| **5.3.1** | | |
| **5.3.2** | | |
| **5.3.3** | | |
| **5.3.4** | | |
| **5.3.5** | | |
| **5.3.6** | | |
| **5.3.7** | | |
| **Shkalla e cilësisë:** | | |

| | | |
|---|---|---|
| **Fusha e cilësisë 5: PERFORMANCA E NXËNËSVE** | | |
| **Kriteri 5.4: Nxënësit janë të angazhuar në aktivitete ekstra-kurrikulare** | | |
| **Treguesit** | | **Trendi** |
| **5.4.1** | | |
| **5.4.2** | | |
| **5.4.3** | | |
| **Shkalla e cilësisë:** | | |

| Fusha e cilësisë 5: PERFORMANCA E NXËNËSVE | | |
|---|---|---|
| **Kriteri 5.5: Nxënësit janë të angazhuar në menaxhimin e progresit vetjak** | | |
| **Treguesit** | | **Trendi** |
| **5.5.1** | | |
| **5.5.2** | | |
| **5.5.3** | | |
| **5.5.4** | | |
| **Shkalla e cilësisë:** | | |

<table>
<tr><th colspan="3">Vlerësimi i fushës së cilësisë</th></tr>
<tr><td colspan="3">Fusha e cilësisë: PERFORMANCA E NXËNËSVE</td></tr>
<tr><td colspan="3">Shkalla e cilësisë:</td></tr>
<tr><th>Përshkrim i performancës së shkollës</th><th>Dëshmitë/evidencat</th><th>Komentet shtesë</th></tr>
<tr><td></td><td></td><td></td></tr>
</table>

| NIVELI I PËRGJITHSHËM I PERFORMANCËS SË SHKOLLËS | | |
|---|---|---|
| **Shkalla e cilësisë:** | | |
| **Përshkrimi i performancës së përgjithshme** | **Përparësitë dhe dobësitë e identifikuara** | **Rekomandimet** |
| | | |

## Fjalorthi

| KONCEPTI | SHPJEGIMI |
|---|---|
| Fushat e cilësisë së institucionit arsimor | Segmentet kryesore të veprimtarisë së institucionit/shkollës. që do të shërbejnë si pika referuese për vlerësimin e performancës së institucioneve arsimore në Kosovë, duke siguruar koherencë në mes të procesit të vetëvlerësimit dhe të vlerësimit të jashtëm të shkollës |
| Institucioni arsimor | Institucion edukativ, arsimor dhe aftësues i cili ofron shërbime arsimore në nivelet KNSA 0-4. Udhëzimi adminstrativ për Vlerësimin e përformancës së institucioneve arsimore në arsimin parauniversitar, iu referohet niveleve KSNA 0-3, në të cilat do të bëhet vlerësimi i përformancës së institucineve në bazë të procedurave të këtij UA. |
| Korniza për sigurim të cilësisë së përformancës së institucionit arsimor | Është politikë arsimore që përcakton: (i) Kriteret e cilësisë së performancës së institucionit arsimor, (ii) Treguesit e performancës së institucionit arsimor, (iii) Nivelet e vlerësimit të performancës së institucionit arsimor dhe (iii) Shkallët e cilësisë së performancës së institucionit arsimor. |
| Kriteret e cilësisë | Janë nën-ndarje të fushave të cilësisë që shërbejnë për të siguruar qasje më sistematike gjatë mbledhjes së të dhënave dhe koherencë në mes të dy proceseve të vlerësimit (vetëvlerësimit dhe vlerësimit të jashtëm). Kriteret e cilësisë përshkruajnë pritshmëritë themelore që duhet të përmbushen nga çdo shkollë që funksionon në Republikën e Kosovës, orientojnë shkollat për avancim të vazhdueshëm të praktikave të tyre ndërsa autoritetet arsimore për avancim të politikave arsimore. |
| Korniza Kurrikulare | Kornizë kurrikulare është dokumenti themelor në të cilin përshkruhen orientimet dhe udhëzimet kryesore për hartimin dhe zbatimin e kurrikulës së arsimit parauniversitar (qëllimet e arsimit, kompetencat kyçe, rezultatet e të nxënit sipas niveleve etj.). |

| | |
|---|---|
| Kurrikula  bërthamë | Kërkesat e përbashkëta për të gjithë nxënësit në aspektin e kompetencave kryesore, lëndët e përbashkëta dhe orientimet e përgjithshme. |
| Përmbajtja mësimore | Tërësia e dijeve, informacionit, fakteve, situatave, veprimtarive etj., të grupuara në një lëndë ose fushë të nxënit, që shërbejnë si bazë për formimin dhe zhvillimin e njohurive të reja dhe kompetencave. |
| Përvoja mësimore | Situatat dhë proceset përmes të cilave nxënësit i fitojnë/zhvillojnë dijet, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet. |
| Performanca e institucionit arsimor | Tërësia e punës së institucionit arsimor qe manifestohet përmes shkallës së arritjes së kritereve të cilësisë së institucionit arsimor dhe e vlerësuar me procesin e vlerësimit. |
| Plani Zhvillimor i Institucionit arsimor/shkollës | Dokument pune i obligueshëm që përgatitet nga institucioni arsimor që bazohet në raportin e vetëvlerësimit dhe që përcakton prioritetet dhe objektivat për sigurimin e cilësisë së punës së institucionit arsimor në periudhën afatmesme. |
| Plani vjetor i veprimit | Dokument pune i obligueshëm që përgatitet nga institucioni arsimor që bazohet në raportin e vetëvlerësimit dhe që përcakton (a) ndryshimet të cilat duhet t'i bëjë shkolla me qëllim të përmirësimit dhe avancimit të performance së saj, (b) masat e nevojshme për realizimin e këtyre ndryshimeve, (c) kohën/afatin e zbatimit të këtyre masave dhe (d) personat përgjegjës për zbatimin e masave të përcaktuara. |
| Vlerësim i brendshëm | Kontrolli i planifikuar, sistematik i standardeve në fushat e cilësisë të përcaktuara nga MASHT, i cili kryhet nga shkolla në intervale të rregullta, duke u bazuar në kriteret e cilësisë dhe treguesit e përformancës siç përshkruhet në Kornizën e sigurimit të cilësisë. |

| | |
|---|---|
| Vlerësim i jashtëm i shkollës | Kontrolli i planifikuar, sistematik i standardeve në fushat e cilësisë të përcaktuara nga MASHT, i cili kryhet në intervale të rregullta nga inspektorët e arsimit në bazë të kritereve të cilësisë dhe treguesve të përformancës të përcaktuara me Kornizën për sigurimin e cilësisë. |
| Treguesit e performancës | Deklarata afirmative të pritshmërive të performances në kuadër të secilit kriter të cilësisë. Treguesit shërbejnë për të konstatuar nivelin e performancës së shkollës në raport me pritshmëritë.  Ata janë referenca kryesore me rastin e vlerësimit të performancës së shkollës në kuadër të kritereve përkatëse. |
| Zhvillimi i cilësisë | Proces i vazhdueshëm në të cilin përfshihet i gjithë stafi i institucionit arsimor dhe bazohet në ciklin e cilësisë: Planifiko – Bëj – Kontrollo – Vepro. |

## Bibliografia


1. B. Elisabeth & T. Bernard. (2007). Qeverisja demokratike e shkollave, Këshilli Evropian. Strasburg.
2. L. Charles, A. Marie-Hélène, A. Gary & Fred Carden. (2005). Përmirësimi i përformancës së organizatës (Nje komplet mjetesh per vetevleresim), ADEA, Prishtinë.
3. M. Carmen , MA. & M. Selim, MA. (2012). Shkolla e mirë, GIZ – Bashkëpunimi Zhvillimor Gjerman, Prishtinë.
4. M. Carmen , MA. & M. Selim, MA. (2012). Plani zhvillimor i shkollës, GIZ – Bashkëpunimi Zhvillimor Gjerman, Prishtinë.
5. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (2009). Strategjia për shkollat promovuese të shëndetit në Kosovë 2009-2018, Prishtinë.
6. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (2011). Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032. Prishtinë.
7. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (2016). Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës (e rishikuar), Prishtinë.
8. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2008). Ligji për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës Nr. 03/L-068 (2008). Prishtinë.
9. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (2010). Plani Strategjik Arsimit në Kosovë 2011-2016, Prishtinë.
10. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Instituti Pedagogjik i Kosovës (2014). Standardet për shkollat mike për fëmijë. Prishtinë.
11. Rrjeti evropian i korrespondentëve nacional të CAF dhe Qendra Evropiane e Resurseve CAF në EIPA .(2013). Korniza e përbashkët e vlerësimit (KPV) Përmirësimi i organizatave publike përmes vetëvlerësimit http://www.eipa.eu/files/File/CAF/Albanian_CAF%202013.pdf

## Kontribuesit që morën pjesë në hartimin e Kornizës për sigurim të cilësisë së performances së shkollës

**Udhëheqës të procesit:**

Kabineti i Ministrit, MAShT

Instituti Pedagogjik i Kosovës

**Falënderojmë për kontributin dhe mbështetjen gjatë këtij procesi:**

Hulumtuesit e Institutit Pedagogjik të Kosovës

Ekspertët vendorë

Zyrtarët e MAShT

Inspektorët e arsimit

Zyrtarët e DKA

Drejtorët e shkollave dhe mësimdhënësit e përfshirë në faza të ndryshme të konsultimeve

Ekspertët e arsimit – zyra e UNICEF në Kosovë

Ekspertët nga Projekti i Binjakëzimit

**Falënderim i veçantë**

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë falënderon të gjithë udhëheqësit e procesit dhe kontribuesit tjerë, vendorë e ndërkombëtarë, të cilët hartuan Kornizën për sigurim të cilësisë së performances së shkollës. Në mënyrë të veçantë, MASHT falënderon UNICEF-in për mbështetje financiare në zhvillimin e këtij dokumenti.

**Botues**

INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS

**Shtypi**

Shtypshkronja "BLENDI " Prishtinë

Tirazhi: 1500 copë

Katalogimi në botim – **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

37.09(496.51)

Korniza për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës në Kosovë / Instituti Pedagogjik i Kosovës. – Prishtinë : Instituti Pedagogjik i Kosovës, 2016. – 72 f. ; 28 cm.

**ISBN 978-9951-591-33-1**

ISBN 978-9951-591-33-1